



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA STUDIMI UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE (MASTER)
NË INDOZEZI**

Ministria e Kërkimit, Teknologjisë dhe Arsimit të Lartë e Republikës së Indonezisë, në kuadër të Programit për Shkëmbimin Arsimor për vendet në zhvillim (Kemitraan Negara Berkembang, KNB) ofron bursa studimi në programin Bachelor ose në programin Master në një nga 16 universitetet e njohura të Indonezisë për studentët e huaj të vendeve në zhvillim.

Programi i Bursave KNB synon të kontribuojë në zhvillimin e burimeve njerëzore si pjesë e angazhimit për të përballuar sfidat globale ekonomike dhe sociale të vendeve në zhvillim. Programi i bursave KNB ofron mundësi për studentët potencialë për të zhvilluar njohuritë dhe kompetencat e tyre fushat e shkencave sociale, të arsimit, shkencave natyrore, të inxhinierisë, etj.

Objektivat e programit:

- Të kontribuojë në zhvillimin e burimeve njerëzore;
- Të nxisë një kuptim të gjithanshëm kulturor dhe të forcojë marrëdhëniet e bashkëpunimit mes vendeve në zhvillim.

Nga pala indoneziane kërkohet që kandidatët e huaj të plotësojnë kushtet e domosdoshme për aplikim:

- Të mos e kalojnë moshën 35;
- Të kenë njohuritë e domosdoshme të gjuhës angleze dhe të jenë të pajisur me certifikatën e TOEFL-it;
- Të jenë të pajisur me certifikata të tjera për kualifikimet përkatëse.

Bursa e studimit Master ofrohet në të gjitha programet e studimit që përfshijnë fushat e shkencave sociale, të arsimit, shkencave natyrore, të inxhinierisë, si dhe disa programe në fushën e mjekësisë si: shëndeti publik, studime farmaceutike dhe infermieri, etj.

Bursa mbulon shpenzimet e udhëtimit ndërkombëtar, transportin e brendshëm, shpenzimet e qëndrimit e të ushqimit, shpenzimet për librat, si dhe shpenzimet për siguracionin shëndetësor.

Përzgjedhja e kandidatit fitues për bursën e studimit do të bëhet nga pala indoneziane. Kandidati i përzgjedhur do t'i nënshtrohet vitit përgatitor të gjuhës indoneziane, i cili fillon në shtator të vitit 2019.

Procedura e aplikimit bëhet përmes sistemit online dhe përfshin:

- a) Plotësimin e formularit të aplikimit, i cili gjendet në adresën e internetit: <http://knb.ristekdikti.go.id>; Kandidatët, do të bëjnë fillimisht regjistrimin online. Pasi të kenë hyrë në sistem, kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit duke përcaktuar fushën e studimit;
- b) Kandidatët, gjithashtu, duhet të ngarkojnë në sistemin *online* kopjet e noterizuara të dokumenteve të legalizuara dhe të përkthyer në gjuhën angleze të dokumentacionit të kërkuar.

Afati i fundit për aplikimin online është data 12 prill 2019.

Bashkëlidhur këtij njoftimi ndodhen materialet informues për kushtet dhe procedurën e aplikimit. Për çdo informacion tjetër referojuni adresave në faqen e website:

1. *Directorate General of Science, Technology, and Higher Education Institutional Affairs*
Ministry of Research, Technology and Higher Education of the Republic of Indonesia;
Jalan Jenderal Sudirman, Senayan,
Jakarta 10270
Phone : +6221 57946063 / Fax: +6221 57946062
<http://www.knb.ristekdikti.go.id>;
Email : beasiswaknb@dikti.go.id;
2. *Director of Public Diplomacy*
Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Indonesia
Jalan Taman Pejambon No. 6, Jakarta
Phone : +6221 3813480 / Fax : +6221 3858035

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS